

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	18.01.2021	Gazetar- kërkesë për informacion nga e-mail	22.01.2021 Është përcjellë përgjigja me e-mail dhe zyrtarisht	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) shërben si njësi e specializuar financiare administrative për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p> <p>Pra një nga detyrat më të rëndësishme të DPPPP është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës konkretisht me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit etj.</p> <p>Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPPP për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale, neni 22/1 ligji nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”(i ndryshuar).</p> <p>Në këtë aspekt vlen të përmendet se pesha më e madhe të rasteve të dërguara nga DPPPP i janë adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), si organi ligj zbatues kryesor në vend dhe i specializuar për kryerjen e veprimeve hetimore, ku për të njëjtën periudhë kohore 2015 – 2019 janë dërguar në total 1426 raste. Më tej evidentohet se nga tërësia e rasteve që Policia e Shtetit referon për pastrim parash në Prokurori, së paku mbi 50% të rasteve e kanë indicie të drejtpërdrejtë nga informacionet e dërguara nga DPPPP, tregues ky i besueshmërisë së informacioneve të dërguara.</p> <p>Për sa i përket rasteve të dërguara në Prokurori, bazuar në statistikat e publikuara në raportet vjetore të DPPPP, rezulton se për periudhën 2015-2019¹ janë dërguar në total 429 raste.</p> <p>Për rastet e dërguara në Prokurori mbetet i lartë numri i rasteve të dërguara në Prokurorinë e Tiranës rreth 56%, ndërsa vërehet një shpërndarje e gjerë e rasteve të tjera në Prokuroritë e rretheve Korçë, Fier, Elbasan, Lezhë , Vlorë, etj.</p> <p>Një ndër drejtimet kryesore të punës së DPPPP është bashkëpunimi ndër-institucional, pa të cilin nuk mund të ketë sukses lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Aktorët kryesorë të përfshirë në këtë</p>	Përfunduar	Jo

¹ Të dhënat e vitit 2020 janë duke u përpunuar dhe ende nuk janë konsoliduar

			<p>bashkëpunim siç është përmendur më lart janë Policia e Shtetit dhe Prokuroria, të cilët trajtojnë informacionet e dërguara nga DPPP. Marrëdhënia më këto institucione në kuadër të trajtimit të rasteve të dyshuara për pastrim parash është gjithnjë e në përmirësim, ku përveç komunikimit shkresor, trajnimeve të përbashkëta, së fundmi janë mbajtur edhe takime për të diskutuar rëndësinë e ecurisë së çështjeve për pastrim parash duke i dërguar ato në gjykim si dhe konfiskimet.</p> <p>Hetimi i rasteve për pastrim parash realizohet në thelb si ç’do hetim tjetër në fushën penale, fillohet zyrtarisht nga prokurori kompetent dhe procedurat hetimore drejtohen po nga prokurori, pas një referimi nga organe të ndryshme si Policia e Shtetit, DPPP, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ILDKPKI etj. por edhe kryesisht.</p> <p>Vështirësitë e hasura në kuadër të veprës penale të pastrimit të parave lidhen kryesisht me hetimin e tyre sesa me detektimin në nivel inteligjence, ku ndër vështirësitë përmendim :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provueshmëria: vështirësia për të siguruar të dhëna të sakta dhe të plota, të cilat përtej çdo dyshimi të arsyeshëm justifikojnë ngritjen e akuzës për këtë vepër; • Ekzekutimi i letër porosive për jashtë shtetit, ku përveç kohës së gjatë të përgjigjes, informacioni që dërgohet nuk është i plotë (këtu ndikon dhe ndryshimi midis legjisllacioneve të shteteve); <p>Po në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’ i ndryshuar DPPP ushtron të drejtën e bllokimit të përkohshëm për 72 orë të transaksioneve dhe pasurive të dërguara nga subjektet raportuese, për të parandaluar tjetërsimin e produkteve kriminale apo përdorimin e tyre për financim të terrorizmit në rastet kur ka të dhëna dhe fakte se një gjë e tillë po ndodh apo mund të ndodhë.</p> <p>Gjatë vitit 2019, nga DPPP janë nxjerrë në total 16 urdhra bllokimi të përkohshëm, kryesisht për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 9,7 milion EUR, nga të cilat janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë ose Gjykatës, rreth 7,8 milion EUR. Duke u bazuar në indiciet e dërguara nga DPPP, në funksion të aseteve të dyshuara me prejardhje kriminale, nga të dhënat e raportuara nga DPPSH, rezulton se janë sekuestruar edhe 940.000 EUR pasuri të paluajtshme, duke e çuar në total vlerën e aseteve të sekuestruara me indicie nga DPPP rreth 8,7 milion EUR.</p> <p>Bazuar në të dhënat statistikore për periudhën 2015-2019 konstatohet një rritje në % e vlerës së sekuestruar së fondeve të bllokuara paraprakisht nga DPPP element ky që tregon bazueshmërinë e veprimeve të DPPP por edhe</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>një bashkëpunim pozitiv me Prokurorinë. Ndër metodat kryesore të përdorura për pastrim parash në vendin tonë përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Investime të në vlera të larta në pasuri të paluajtshme nga individë/persona juridik me burim të panjohur fondesh apo fonde të dyshuara nga aktivitete kriminale; • Qarkullim të dyshimtë të fondeve (depozitim/transferta) nga shoqëri tregtare të regjistruara rishtazi apo që nuk realizojnë aktivitet tregtar normal të vazhdueshëm dhe në përputhje me profilin e transaksioneve të llogarive; • Përfitim transfertash në llogari të shoqërive tregtare pa një lidhje të qartë me dërguesin e fondeve apo edhe për qëllimin e përfitimit; • Pagesa të përsëritura për shuma të mëdha të akumuluar në kohë, duke përfshirë edhe përdorimin e çekut, në favor të personave juridik, të cilët nuk duket se kanë ndonjë marrëdhënie mes palëve. • Përfitim të fondeve në llogari të shoqërive tregtare/ individ nga vende të cilësuar me risk për pastrim parash të pashoqëruara me dokumentacion mbështetës; • Përftim/dërgim të fondeve nga individëve pa një lidhje të qartë midis dërguesit dhe përfituesit; • Depozitime në vlera të larta në llogari bankare me burim të panjohur të ardhurash apo që nuk përputhen me profilin financiar të personit/subjektit; • Sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga për të tretë pa u konstatuar lidhje të mundshme mes palëve; • Transaksione financiare të kryera nga persona me precedentë të mëparshëm penalë apo persona të lidhur me ata me precedentë. <p>Për sa i përket identifikimit të burimit të fondeve/pasurisë, veprimtarisë së paligjshme për aq sa është e mundur bazuar në të dhënat e disponuara dhe siguruara rezultojnë se për 34% të rasteve të dërguara nga DPPPP në Polici dhe Prokurori (total për 5 vite 1855) është bërë e mundur identifikimi i një veprës mëmë gjeneruese. Nga këto raste², rezultojnë se kemi një dominim të veprës penale të “Trafikimit/prodhimit të lëndëve narkotike” me 28% të rasteve, 13% lidhen me veprën penale të “Evazionit fiskal”. Veprat e tjera penale kanë një peshë më të vogël si ‘Mashttrim, mashttrim financiar, mashttrim kompjuterike’ me 11% të rasteve, ‘Shpërdorim detyre apo korrupsion</p>		
--	--	--	---	--	--

² Kur është mundur idenfikimi i veprës mëmë

			<p>kryesisht pasiv' me 7.5% , 'Trafikim i qenieve njerëzore / shfrytëzim prostitucioni' me 3.5%, etj.</p> <p>Pra bazuar në të dhënat që DPPP disponon, në analizat e riskut të kryera, në shkëmbimet të informacionet me institucionet e përfshira në luftën kundër pastrimit të parave vlerësohet se vepra penale kryesore gjeneruese, të ardhurat e të cilës investohen në pasuri të paluajtshme, veprimtari tregtare dhe financiare është “Prodhimi/trafikimi i lëndëve narkotike”.</p> <p>Metodat e përdorura për pastrimin e parave që gjenerohen nga “Trafikimi/prodhimi i lëndëve narkotike” janë nga ato më të thjeshtat te ato më komplekset si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i subjekteve juridike apo edhe personave të tretë për investime/blerje pa një lidhje të dukshme me veprimtari kriminale të pajustificuara nga të ardhurat e tyre por de facto zotërohen nga persona të përfshirë në veprimtari kriminale; - Investimi në pasuri të paluajtshme emër të një shoqërie tregtare ekzistuese të zotëruar nga persona të dyshuar si të përfshirë prodhim/trafikim të lëndëve narkotike, në vlera të pajustificuara me burime të ligjshme, - Depozitim me para në dorë në banka me burim të dyshuar nga trafikimi i lëndëve narkotike; - Dhënia e huave të larta nga ortaku (i dyshuar si i përfshirë në veprimtari kriminale) për shoqërinë tregtare në vlera të konsiderueshme; - Përdorimi i kredive nga institucionet bankare dhe jo bankare, për të justifikuar investimet; - Përfitimi i transfertave të larta në llogari biznesi të personit të dyshuar në prodhim/trafikim të lëndëve narkotike nga shoqëri pa një lidhje të qartë. <p>7. Shqipëria ka hyrë në listën e vendeve nën monitorim, në Shkurt të vitit 2020. Në këtë drejtim Shqipëria, është angazhuar plotësisht për realizimin e kërkesave, ku ja vlen të theksojmë se pavarësisht situatës shumë të vështirë të krijuar nga pandemia globale Covid-19 për një periudhë gati 10 mujore u realizuan nismat e më poshtme ligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i ligjit “Për regjistrin e pronarëve përfitues”: Ligji nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i cili ka hyrë në fuqi në Shtator të vitit 2020. Regjistri i Pronarëve Përfitues do të jetë i aksesueshëm nga institucionet shtetërore dhe publiku. - Miratimi i ligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”: Ligj nr. 154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” u miratua nga Kuvendi më 17 dhjetor 2020 dhe do të hyjë në fuqi në fund të muajit 		
--	--	--	---	--	--

				<p>Janar 2021. Ky ligj krijon një mekanizëm efektiv për vendosjen në dispozicion të informacioneve të sakta dhe të përditësuara për çdo mbajtës të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndjekje në mënyrë të koordinuar ndërinstucionale nga DPPP e masave zbutëse sipas Vlerësimit Kombëtar të riskut 2019 dhe analizave sektoriale dhe të produkteve, për të mundësuar një kuptim më të qartë të riskut të pastrimit të parave dhe një qasje drejt parandalimit e ndëshkimit të aktiviteteve kriminale dhe personave të përfshirë në pastrimin e parave. - Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit Prokurori e Përgjithshme-Ministri e Brendshme-Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në muajin Korrik të 2020, nëpërmjet së cilës synohet rritja e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Në këtë drejtim janë krijuar në prokuroritë e rretheve kryesore sektorë të rinj të dedikuar për pastrimin e parave dhe krimet ekonomike. <p>Ndërkohë në proces për t'u realizuar janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi elektronik i menaxhimit të letër porosive nga Ministria e Drejtësisë; - Ndryshimet në ligjin për Noterinë, nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim kontrollin e lidhjeve kriminale të të licencuarit dhe personave të lidhur me të, si dhe të mundësohet pezullimi/heqjen e licencave për rastet e moszbatimit nga noterët të legjislacionit parandalues; - Miratimi i ligjit të ri dhe rregullimi i profesionit të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme (aktualisht për diskutim dhe miratim në parlament). Projektligji parashikon kontrolle për të parandaluar qenien përfitues fundorë apo kontrollues të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme elementët kriminalë apo personat e lidhur me ta; - Miratimi i ligjit për regjistrimin e organizatave jo fitimprurëse, me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për këtë sektor të rëndësishëm. Aktualisht projektligji është për diskutim në komisionet parlamentare. 		
2	18.01.2021	Gazetar- kërkesë për informacion nga e-mail	22.01.2021 Është përcjellë përgjigjja me e-mail	<p>Në luftën kundër financimit të terrorizmit përfshihen një numër i madh i institucioneve shqiptare, ku më të rëndësishmet përmendim:</p> <p>Policia e Shtetit: Shërbimi Informativ Shtetëror: Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPPP) Banka e Shqipërisë: Ministria e Drejtësisë: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe</p>	Përfunduar	Jo

Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm

Në funksion të parandalimit të financimit të terrorizmit Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar dhe Ligji nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” i ndryshuar, parashikon një sërë subjektesh si bankat, shoqëritë e transfertave, noterë, shoqëri ndërtimi, zyrat e këmbimeve valutore, etj. të cilët kanë detyrime për marrje masash për identifikimin, klientëve të tyre /klientëve potencialë e më tej monitorimin, sigurimin, mbajtjen e të dhënave për burimin e fondeve, të përcaktimit të risqeve brenda subjektit, të trajnimit të punonjësve të tyre, të raportimit të aktiviteteve të dyshimta, implementimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur etj. DPPPP si njësi e inteligjencës financiare ka si detyrë thelbësorë mbledhjen e rasteve të dyshimta/sinjalizimeve, analizimin e tyre, sigurimin e të dhënave shtesë kur duhen. Në konkludim të rasteve, kur ka dyshime për veprimtari kriminale bashkëpunohet me Policinë e Shtetit, SHISH apo Prokuroritë.

Në një periudhë 5 vjeçare (2015-2019) janë sinjalizuar si raporte të aktivitetit të dyshimtë (RAD) nga subjekte e ligjit (kryesisht banka) 54 raste me dyshime që lidhen me kategorinë “financim e terrorizmi” të cilat pas analizimit të mirëfilltë që DPPPP ka bërë ndaj RAD-ve dhe mbledhjes së të dhënave shtesë për to, kryesisht nuk kanë rezultuar dyshime për FT.

Tipologjitë e dërguara nga subjekte raportuese në raste të tilla janë si vijon:

- Ngjashmëri në gjeneralitete me persona/subjekte të listuar në lista sanksionesh të personave të shpallur për lidhje me terrorizëm apo financim të tij, të cilat nga verifikimet shtesë të DPPPP nuk kanë rezultuar të tilla;
- Transfertat (hyrje dhe dalje) me disa vende, të cilat njihen si vende origjinë apo të përfshira në terrorizëm, apo zona konfliktesh të lidhura me terrorizëm,
- Transaksione nga persona që kanë ngjashmëri në gjeneralitete me persona të arrestuar për vepra që lidhen me terrorizmin apo financimin e tij.

Këtu vlen të përmendet fakti se kryesisht subjektet banka dhe shoqëri transfertash (të cilat mbajnë peshën kryesore të transaksioneve financiare në vend) janë tepër sensitive ndaj këtij risku duke:

- Implementuar sisteme efikase që gjenerojnë alerte automatike për identifikim e rasteve kur një person i listuar apo dyshuar si i

			<p>përfshirë në financim terrorizmi, tenton të kryejë një veprim financiar apo të krijojë një marrëdhënie me subjektin;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duke trajnuar stafin e tyre për riskun për FT që subjekti ballafaqohet; • Duke raportuar raste të cilat përmbajnë dyshime për financim terrorizmi apo edhe raste për alarme false për financim terrorizmi, me qëllim verifikim më tej nga DPPPP, element ky që vlerësohet pozitiv duke treguar efikasitetin e zbatimit të masave ; <p>Për sa i përket kapaciteteve njerëzore, profesionale të DPPPP, për trajtimin e rasteve të dyshuara për FT vlerësohen se janë në nivelin e duhur ku punonjësit e DPPPP trajnohen në mënyrë të vazhdueshme për sa i përket këtij aspekti dhe për më tepër rastet e sinjalizuara për dyshime për financimin terrorizmi raportohen në kohë reale dhe trajtohen me prioritet maksimal.</p> <p>Për sa i përket trajnimeve të personave të përfshirë në luftën kundër financimit të terrorizmit, vlen të përmendet së në bashkëpunim me projekte të ndryshme OSBE dhe UNDOC, përfaqësues të DPPPP, SHISH, DPSH dhe Prokurorisë, gjatë periudhës 2018-2019, janë trajnuar nga ekspertë të jashtëm me qëllim që më tej të përcjellin nëpërmjet trajnimeve eksperiencën e fituar në një numër të madh punonjësish të tjerë të këtyre institucioneve.</p> <p>Gjithashtu DPPPP organizon në mënyrë të vazhdueshme trajnime për subjektet raportuese për njohuritë në lidhje me financimin e terrorizmit dhe në faqen e saj zyrtare publikon tipologji, trende me qëllim përforcimin e njohurive për masat që duhet të marrin edhe për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre ndaj këtij rreziku. Këtu përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trajnim i zgjeruar në bashkëpunim midis DPPPP dhe DPT për OJF të cilat ndërkombëtarisht njihen për rrezikun për përfshirje apo përdorje për financim terrorizmi, • Publikimet në faqen tonë zyrtare të tipologjive dhe të udhëzuesve të FATF që lidhen edhe me FT;³ • Hartimi dhe publikimi i një Udhëzuesi për OJF për ti ndihmuar që ato të veprojnë në përputhje me legjislacionin kombëtar për parandalimin e financimit të terrorizmit dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.⁴ • Hartimi dhe publikimi tipologjive të financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë;⁵ 		
--	--	--	---	--	--

³ <https://fiu.gov.al/sq/publikime/>

⁴ <https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Udhëzues-per-Organizatata-Jo-Fitimprurese.pdf>

⁵ <https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Tipologji-per-financimin-e-terrorizmit.pdf>

				<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi dhe publikimi i një udhëzuesi për Sanksionet Financiare në lidhje me Terrorizmin, Financimin e Terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë⁶. • Publikimet në faqen zyrtare të risqeve për FT që lidhen me situatën e re të krijuar nga pandemia “Covid 19”⁷ • Trajnimet çdo ditë të premtë pranë ambienteve të DPPP për kategori të ndryshme të subjektet e ligjit;⁸ <p>Reagimi i Shqipërisë ndaj rrezikut për akte terroriste apo financimin e tij deri tani ka qenë nëpërmjet masave, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet ligjore me ligjin nr. 144/2013 dhe ligjin nr. 98/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë’”, ku përveç nenit 265, të Kodit Penal, “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, u shtuan nenet 265/a, 265/b dhe 265/c përkatësisht: “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj”, “Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj”, “Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj”; • Hartimi dhe miratimi i Vlerësimit Kombëtar të riskut për PP/FT, si dhe i planit të veprimit përkatës, që ka pasur në fokus edhe rrezikun e FT; • Kalimi i veprës penale “Financim i terrorizmit”, si objekt i punës së Drejtorisë së Antiterrorit dhe ngritja e Njesisë për Hetimin e Financimit të Terrorizmit, në përbërje të kësaj drejtorie, në zbatim të rekomandimeve të MONEYVAL, të KE-së; • Hartimi dhe miratimi i “Strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”, miratuar me VKM-në nr. 930, datë 18.11.2015; • Hartimi i “Strategjisë së Sigurisë Kombëtare”, me VKM-në nr. 930, datë 18.11.2015; • Krijimi i “Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)”, si institucion në varësi të Kryeministrit; • Një vit më vonë nga hartimi i VKM-së nr. 930, datë 18.11.2015 u emërua Koordinatori Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (KEDH), me qëllim bashkërendimin e zbatimit të strategjisë kombëtare. Pothuajse dy vjet më vonë (VKM 737, dhjetor 2018), Zyra Kombëtare e Koordinatorit 		
--	--	--	--	---	--	--

⁶ <http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/Udh%C3%ABzues-Sanksionet-nderkombetare-2020.pdf>

⁷ http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Risqet-PP_FT-Covid-19.pdf

⁸ <https://fiu.gov.al/sq/trajnim-me-subjektet-e-legjislacionit-per-parandalimin-e-pastrimit-te-parave-6/>, <https://fiu.gov.al/sq/5655/>; <https://fiu.gov.al/sq/trajnim-per-parandalimin-e-pastrimit-te-parave-dhe-financimin-e-terrorizmit-ne-bashkepunim-me-ieka/>

				<p>të KEDH-së u shndërrua në Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH e njohur edhe si qendra CVE) si agjenci në varësi të Kryeministrit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në kuadër të procesit të riadhesimit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, miratuar me VKM-n nr. 826, datë 26.10.2020, qendra CVE ka për detyrim koordinimin ndërinstucional me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë, mbështetjen e institucioneve vendase, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjithë procesit; • Anëtarësimi i strukturave të Policisë së Shtetit në pikat fokale “HYDRA”, “DOLPHIN” dhe “TRAVELLERS”; • Monitorimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, të individëve shtetas shqiptarë dhe të huaj, të dyshuar për përfshirje në konfliktin e armatosur jashtë vendit, në bashkëpunim me shërbimet partnere të huaja dhe agjencitë inteligjente e ligj zbatuese në vend; • Përfshirja e 18 individëve nga Shqipëria, të dyshuar për veprimtari kriminale në fushën e terrorizmit, në “Lista e brendshme e personave të shpallur”, me VKM, bazuar në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”; • Implementimi nga Policia e Shtetit e programit “Kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet”; • Hartimi dhe implementimi nga institucionet përgjegjëse i Planit dhe Planit Shtesë të Veprimit Ndërinstucional, “Për pritjen dhe ri integrimin e shtetasve që pritet të kthehen nga vendet e konfliktit Siri-Irak”, miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 169, datë 1.11.2018, dhe nr. 148, datë 5.11.2019; • Vendi ynë së fundmi ka aprovuar Strategjinë për Mbrojtje Kibernetike 2018-2020 qëllimi i të cilës është mbajtja e një hapësire kibernetike të besueshme e të sigurt, strategji e cila shtrin efektet edhe në parandalimin e terrorizmit kibernetik; • Aplikimi i programit për “Shkollat për Komunitete më të Sigurt” me qëllim edukimin e mësuesve në të gjithë Shqipërinë për rreziqet e radikalizimit të dhunës në mesin e të rinjve; • Nënshkrimi, implementimi dhe zbatimi i disa marrëveshjeve e protokolleve të bashkëpunimit me disa vende të rajonit, Evropës dhe SHBA-së, në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit (aktualisht 21 marrëveshje e protokolle bashkëpunimi); • Miratimi së fundmi i Strategjisë Ndër sektoriale ‘Të Luftës Kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe të planit të veprimit 2021–2023; • Realizimin e takimeve të vazhdueshme mes organeve të inteligjencës dhe 		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>ato të zbatimit të ligjit për raste të dyshuara për financim terrorizmi.</p> <p>FATF në 21 Shkurt 2020 ka vendosur për përfshirjen e Shqipërisë në listën e vendeve në monitorim, proces për të cilin është hartuar dhe ndiqet një plan veprimi specifik për adresimin e të gjitha mangësive.</p> <p>Vlen të evidentohet që në këtë plan veprimi nuk janë evidentuar mangësi dhe as nuk kërkohen masa konkrete nga vendi ynë në lidhje me parandalimin, analizimin apo ndjekjen e rasteve të dyshuara për financimi terrorizmit. Ky rezultat është produkt i një pune intensive të një sërë organesh, në periudhën 2018-2019, në kuadër të adresimin të problematikave të evidentuara nga vlerësimi i vitit 2018 i Komitetit MONEYVAL për Shqipërinë në lidhje me sistemin e parandalimit dhe goditjes së PP/FT.</p> <p>Pavarësisht sa më sipër, trajtimi i rasteve të dyshimta që lidhen me FT mbetet prioritet parësor i të gjitha strukturave të cituara më sipër.</p>		
3	04.02.2021	Individ- Kërkesë për informacion	05.02.2021 Është përcjellë përgjigja me e-mail	<p>Informojmë se subjekti ka detyrim që të bëjë vetë verifikimin dhe ky detyrim nuk ndërvaret nga të dhënat e gjendura në QKB. Bazuar në legjislacionin në fuqi, QKB nuk realizon verifikime, por mbledh dokumentet që kryesisht janë vetë deklarime.</p> <p>Vigjilenca e duhur dhe e zgjeruar kur përcaktohet, nuk janë proces i dyfishtë por bazë e marrëdhënies subjekt-klient, për këtë arsye duhen realizuar vetë nga subjekti, përfshirë edhe pjesën e pronarëve përfitues, edhe për shkak të detyrimeve që rrjedhin nga ligji i miratuar së fundmi për regjistrin e pronarët përfitues (shih neni 2 pika 5 dhe neni 6 pika 3).</p>	Përfunduar	Jo
4	10.02.2021	Individ- Kërkesë për informacion	15.02.2021 Është përcjellë përgjigja me e-mail	Disa vendime dënimi të formës së prerë. Ju informojmë se për të tjera vendime mund të bëni kërkesë drejtpërdrejtë në gjykatë.	Përfunduar	Jo
5	09.03.2021	Gazetar- kërkesë për informacion nga e-mail	16.03.2021 Është përcjellë përgjigja me e-mail dhe zyrtarisht me shkresë	<p>Në lidhje me pyetjen e parë ja vlen të theksojmë se raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA evidenton qartë pritshmërinë për përmirësim pas reformave dhe sa i përket luftës më efektive ndaj pastrimit të parave, por që mbetet sfidë e organeve të gjyqësori. Ndërkohë për fushën e veprimtarisë së DPPPP⁹ nuk evidentohen problematika.</p> <p>Në lidhje me pikën e dytë informojmë se, DPPPP nuk ka të dhëna që këto para vijnë në shumicën e rasteve nga jashtë vendit. DPPPP publikon tipologji</p>	Përfunduar	Jo

⁹ Fusha specifike që DPPPP mbulon është parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit, në funksion të të cilës DPPPP shërben si njësi e specializuar financiare në mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

dhe tregues që i publikon në raportet vjetore në vite të cilat për më shumë informacion i gjeni në faqen elektronike zyrtare të DPPP, hapësira e publikimit të “Raporteve vjetore” <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/> .

Në lidhje me pyetjen e tretë informojmë se, rastet e dërguara nga DPPP për dy vitet e fundit në Policinë e Shtetit, Prokurori dhe në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për vitin 2019 janë në total 309 raste, ndërsa për vitin 2020 janë në total 311 raste. Më poshtë po ju paraqesim në mënyrë më të hollësishme një tabelë me numrin e rasteve të referuara në secilin organ:

Referimet	Viti 2019	Viti 2020
Referimet në Prokurori	25	41
Referimet në Polici	241	227
Referime në DPT	43	43
Total	309	311

Në lidhje me pyetjen, në të cilën kërkon informacion mbi numrin e shtetasve të huaj të përfshirë në aktivitetin kriminal për pastrimin e parave në Shqipëri, informojmë se nuk ka një metodë statistikore për ta nxjerrë këtë informacion, të paktën në dispozicion nga DPPP. Sugjerojmë t’i drejtoheni institucionit të Prokurorisë të Përgjithshme dhe Policisë së Shtetit për të marrë informacionin e kërkuar, nëse mbajnë statistika të posaçme dhe për këtë zë.

Në lidhje me pyetjen, çështjen/ referimin e dërguar së fundmi në organin e prokurorisë për hetime, ju bëjmë me dije se bazuar në Ligjin nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar, neni 22/1, çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPP-ja për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.

Në lidhje me pyetjen, për sa i përket numrit të çështjeve të referuara nga DPPP-ja në organet e hetimit, përgjatë gjithë viteve që nga krijimi i DPPP, ju vëmë në dijeni se informacion të plotë dhe gjithëpërfshirës e gjeni në faqen elektronike zyrtare të DPPP, hapësira e publikimit të “Raporteve vjetore” <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/> , ku janë publikuar raportet vjetore ndër vite.

6	08.04.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	14.04.2021 Është përcjellë përgjigjja me e-mail	<ul style="list-style-type: none"> • DPPP shërben si njësi e specializuar financiare administrative për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “<i>Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</i>” i ndryshuar. • Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. • Pra një nga detyrat më të rëndësishme të DPPP është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës konkretisht me Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, etj. • Në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 “<i>Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</i>” i ndryshuar, parashikon një sërë subjektsh si bankat, shoqëritë e transfertave, noterë, shoqëri ndërtimi, zyrat e këmbimeve valutore, etj. të cilët kanë detyrime për marrje masash për identifikimin, klientëve të tyre /klientëve potencialë e më tej monitorimin, sigurimin, mbajtjen e të dhënave për burimin e fondeve, të përcaktimit të risqeve brenda subjektit, të trajnimit të punonjësve të tyre, implementimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur, të raportimit pranë DPPP të aktiviteteve të dyshimta etj. • Pra në thelb veprimtaria e kryesore e DPPP përqendrohet në analizimin e rasteve të dyshimta të sinjalizuara nga subjekte e sipërpërmendura. Në lidhje me platformat FOREX të pa licensuara, ushtrimi i pa licencuar i aktivitetit bankar ose financiar është i parashikuar si vepër penale në nenet në vijim të KP : <ul style="list-style-type: none"> • Neni 170/c Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012); • Neni 170/ç Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 25); <p>dhe në këtë kuadër detyrimin për të bërë kallëzim penal e ka nëse e konstaton bazuar në KPP çdo punonjës publik (Neni 281 Kallëzimi nga nëpunësit publikë) dhe çdo shtetas (Neni 283 Kallëzimi nga ana e shtetasve).</p> <p>Bazuar në kërkesën e dërguar ju informojmë se DPPP kryen inspektive vetëm në subjektet që janë subjekte të ligjit 9917 duke i evidentuar si të tillë ose nga listat e licensimeve të autoriteteve kompetente, ose nga objekti i veprimtarisë që kanë regjistruar në QKB, por nuk ka trupë terreni që të shkelë</p>	Përfunduar	Jo
---	------------	---	--	---	------------	----

				<p>territorin për subjekte që nuk janë regjistruar. Rastet e konkurrencës së pandershme nga subjekte të paregjistruara, adresohen nga subjektet e regjistruara apo sinjalizues të tjerë tek autoriteti I fushës dhe jo tek DPPPP. Edhe DPPPP ka përcjellë sinjalizimin në ato raste kur ka hasur indicia për transaksione që mund të konsideroheshin si veprime të tilla qoftë tek Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve, por edhe tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti i fushës.</p> <p>Në rastet kur nga subjektet e ligjit sinjalizohet një rast i dyshimtë që lidhet me transaksione apo dyshime për ‘platforma on line’ rasti parimisht trajtohet si rastet e tjera dhe në rast se konstatohen dyshime, dërgohen më tej për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese apo të inteligjencës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar DPPPP shkëmben informacion edhe me njësitë homologe të huaja (kërkesa drejt dhe nga homologët, informacione spontane). Gjatë viteve të fundit (2017-2020) është vënë re një tendencë e raportimit nga subjektet e ligjit të rasteve të dyshimta të aktiviteteve (skema të dyshimta të pastrimit të parave) që lidhen me shoqëri që operojnë si ‘Call Center’/‘Shoqëri Telematike’. - Bazuar në analizimin e tipologjive të këtyre rasteve (përfshirë këtu edhe nga shkëmbimi i informacioneve me njësi homologe të huaja) nuk janë evidentuar nga DPPPP tipologji apo trende që lidhen specifikisht me platforma online mbi shitjen dhe blerjen e aksioneve. <p>Në vitin 2018, DPPPP ka kryer një analizë në lidhje me personat (fizik tregtar +juridik në një nga format e njohura) që ushtrojnë aktivitet si ‘Call Center.’/Telematike dhe problematikat e evidentuara janë adresuar në organet përkatëse.</p> <p>Rastet e referuara në organet ligj zbatuese detajohen sipas veprës së origjinës. Më poshtë po shkëpusim grupimin ku janë përfshirë edhe rastet në interesin tuaj</p> <p>Për veprën e origjinës “Mashttrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterik për vitin 2015 (12 raste), viti 2016 (17 raste), viti 2017 (15 raste), viti 2018 (13 raste), viti 2019 (18 raste).</p> <p>Për vitet të mëparshme si dhe për statistika të tjera ju ftojmë të konsultoheni më raportet vjetore që mund t’i gjeni në faqen tonë në web http://fiu.al/sq?s=raport.</p>		
7	06.05.2021	Gazetare-kërkesë për informacion nga e-mail	11.05.2021 Është përcjellë përgjigjja me e-mail	<p>Referuar email të dërguar nga Ju, në datë 06.05.2021, mbi plotësimin e “Pyetësorit për shtetet që janë pjesë e OSBE”, në vijim do të gjeni përgjigjet për secilën nga pyetjet e këtij pyetësori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bazuar në raportin e raundit të pestë të vlerësimit të Shqipërisë nga komiteti 	Përfunduar	Jo

			<p>Moneyval i Këshillit të Evropës (https://www.coe.int/en/web/moneyval/jurisdictions/albania), niveli i përputhshmërisë së subjekteve financiare është vlerësuar në nivel të lartë ndërkohë që për profesionet e lira jo-financiare (noterët, avokatët, lojërat e fatit dhe ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme), është evidentuar një nivel më i ulët përputhshmërie.</p> <p>DPPPP luan një rol të rëndësishëm në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të këtyre subjekteve të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar). Të dhëna më të detajuara për trajnimet e organizuara ndër vite për këtë qëllim mund të sigurohen nga raportet vjetore të publikuara në faqen zyrtare www.fiu.gov.al.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nisur nga vlerësimi i sistemit parandalues në vend me nivel përputhshmërie substancial në vlerësimin e fundit të Moneyval (2018) si dhe gjetjet e vlerësimeve të ndryshme të riskut, nuk ka të dhëna për “ndikim/rrezik” të shtuar në vendit tonë nga flukset financiare, krahasuar me vendet e rajonit por edhe më gjerë. • Kuadri ligjor Shqiptar në këtë drejtim është shumë i gjerë. Për pjesën e fushës së veprimtarisë që DPPPP do të veçonim Ligjin nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. • Sa i përket ushtrimit të funksioneve të DPPPP në këtë drejtim bëjmë me dije se dispozitat e Ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar) kanë përcaktuar qartë mënyrën e raportimit dhe detyrimet e subjekteve raportuese (neni 12 “Raportimi tek autoriteti përgjegjës”¹⁰). DPPPP në ushtrim të funksioneve të saj i kushton një 	
--	--	--	--	--

¹⁰ Neni 12

Raportimi tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

2. Kur subjekti, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t’ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja dijoni, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejjimin e transaksionit ose nxjerrjen e urdhrin të bllokimit. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit.

			<p>vëmendje të veçantë rritjes së ndërgjegjësimit të subjekteve raportuese nëpërmjet trajnimeve, si dhe nëpërmjet inspektimeve periodike mbikëqyr nivelin e përputhshmërisë veprimtarisë të subjekteve raportuese në raport me kuadrin ligjor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar) është shumë i qartë në procedurat që duhet të ndiqen nga subjektet raportuese. Në rast konstatimi të mosrespektimit të dispozitave ligjore, DPPPP bazuar në nenin 27 “Kundërvajtjet administrative” procedon me marrjen e një ose disa masave administrative. • DPPPP në zbatim të ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar) ka të përcaktuar qartë në nenin 22 “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës” ku sekuestrimi, rikuperimi apo rikthimi i të ardhurave të gjeneuara nga krimi nuk janë pjesë e detyrave dhe funksioneve të DPPPP. • DPPPP ka bashkëpunim shumë të mirë dhe të konsoliduar në vite me njësitë homologe rajon. • Në kuadër të funksioneve që DPPPP ushtron në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar deri aktualisht bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë dhe efektiv. Nismat ligjore Evropiane për ngritjen e regjistrave qendror të llogarive bankare (regjistër i cili po ngrihet edhe në Shqipëri) do e përmirësojnë akoma më shumë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në kuadër të kthimit të përgjigjeve në një kohë më të shkurtër dhe efektive. • Vendet në rajon dhe më gjerë janë subjekt i të njëjtit proces vlerësimi të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare të FATF (Financial Action Task Force) si dhe Shqipëria, në të cilat evidentohen dhe problematikat përkatëse për çështjet e parashtruara në këtë pyetje. • DPPPP vepron në zbatim të ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar). Sugjerojmë që kjo pyetje duhet ti drejtohet Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. 	
--	--	--	--	--

3. Subjekteve u kërkohet t’i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve. Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen me organet apo ndërmarrjet publike.

8	25.05.2021	Gazetar- kërkesë për informacion nga e-mail	02.06.2021 Është përcjellë përgjigjja me e-mail	<p>Referuar kërkesës për informacion, cituar në lëndë, në vijim do të gjeni përgjigjet për secilën nga pyetjet e parashtruara:</p> <p>- Raporti i fundit i Moneyval është raporti i dytë për përputhjen teknike në kuadër të procedurës së përforcuar të monitorimit në të cilën gjendet vendi ynë. Shqipëria ndodhet në monitorim të përforcuar për shkak mangësish në efektivitet dhe jo për përputhshmëri teknike. Shqipëria ka më pak se 8 rekomandime nga 40 rekomandime me vlerësim pjesërisht e përputhur dhe është përputhshëm mjaftueshëm. Paralelisht me raportimin çdo 4 muaj në ICRG- FATF për efektshmërinë, Shqipëria raportin 1 herë në vit në Moneyval për pjesën e atyre pak rekomandimeve që janë ende PC (pjesërisht të përputhur). Raporti këtë herë evidenton punën e bërë si dhe mangësitë teknike që ende duhet të adresohen, proces në të cilin kanë kaluar shumë vende të tjera anëtare të Moneyval.</p> <p>- Raporti vjetor 2020 i Drejtorisë të Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) gjendet në faqen zyrtare të internetit https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti_Vjetor_2020.pdf. Ndërkohë raporti i “<i>technical compliance</i>” i Moneyval në Dhjetor 2019 dhe Prill 2021 i gjeni në linqet si më poshtë: https://rm.coe.int/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing-measures-albania/16809988c0 https://rm.coe.int/moneyval-2021-2-fur-albania/1680a2982c</p> <p>- Bankat dhe institucionet që citohen më sipër nuk kanë rol ulje të ekonomisë informale dhe janë kontribuues të sistemit parandalues në vend. Efektiviteti i bankave (IO 4) është vlerësuar “<i>substantial</i>” nga MER. Nga 18 vende anëtare të Moneyval që janë vlersuar deri tani, vetëm Shqipëria dhe Armenia kanë arritur këtë vlerësim të lartë të efektivitetit. Më poshtë gjeni linkun për informacion më të zgjeruar në lidhje me vlerësimet e Moneyval/FATF për çdo kriter, për shtetet anëtare. 4th-Round-Ratings.xlsx</p> <p>- Sugjerojmë të konsultoni faqen zyrtare të internetit të DPPPP linku https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/ (në faqen 9-11 në nënkapitullin “<i>Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit</i>”), ku janë publikuar raportet vjetore në vite në të cilën do të gjeni informacionin e plotë për sa kërkoni. Ndërkohë sugjerojmë të merrni informacion nga Policia ku DPPPP dërgon pjesën më të madhe të informacioneve lidhur me ecurinë e rasteve, nëse ato janë referuar në prokurori.</p> <p>C ‘farë fluksi paraje ka hyre ne Shqipëri në dy vitet e fundit? DPPPP nuk mbledh dhe nuk disponon informacion të tillë.</p>	Përfunduar	Jo
---	------------	---	--	--	------------	----

			<p><i>Duke zgjeruar rrethin e hetimit deri tek familjarët e afërt e të largët të zyrtarëve, a ka një numër të personave të hetuar se posedojnë pasuri në emrat e tyre?</i> Për këto të dhëna duhet t'u drejtoheni Prokurorisë.</p> <p><i>A ndiqet depozitimeve dhe llogarit OFShOR në vend?</i> Së pari nuk ka një përcaktim të gjithë pranuar se çfarë nënkupton “off-shore”. Më tej, në mënyrë të thjeshtuar bashkëpunimi në lidhje me depozitimet që mund të bëhen në llogari jashtë vendit funksionon mbi bazë të bashkëpunimit mes njësisive të inteligjencës financiare, të cilat për rastet që dyshojnë dhe çmojnë nevojën e bashkëpunimit, mund ti drejtohen DPPP si FIU Shqipëri. Nga ana e institucionit tonë i jepet përparësi bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në rastet kur nga ky bashkëpunim rezultojnë edhe të dhëna për shtetas që lidhen me Shqipërinë, rastet analizohen dhe përcillen për veprime të mëtejshme në organet ligj zbatuese.</p> <p><i>A është zbuluar ndonjë skeme e pastrimit të parave dhe në rast se po cila?</i> Skemat e tilla janë të larmishme, lutem konsultoni faqen tonë zyrtare për këtë qëllim, si raportet vjetore por edhe tipologjitë e publikuara. (në faqen 13-18 të raportit).</p> <p><i>Lajmi se në Shqipëri është qarkulluar një para e pisët e cila arrin në 13 miliard dollarë a vazhdon të jetë reale?</i> Ju lutem vënien në dispozicion të lajmit/ referencës që keni konsultuar, me qëllim dhënien e përgjigjes</p>		
--	--	--	--	--	--

9	21.07.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	23.07.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Në vijim të pyetjeve të ardhura me email, datë 21 Korrik (ora 4:24 PM), Ju lutemi, së pari të specifikoni se cilit subjekt/ subjekte i referoheni me “Kompani Forex”?</p> <p>Subjektet që i nënshtrohen ligjit sipas nenit 3 të Ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), ligji organik në bazë të të cilit funksion Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) nuk ka të sanksionuar subjekte me emërtesë “Kompani Forex”.</p> <p>Nëse me “Kompani Forex” i referoheni në email tuaj Zyrave të Këmbimit Valutor (ZKV), Ju vëmë në dijeni se institucioni licencues dhe mbikëqyrës i tyre në bazë të kuadrit ligjor Shqiptar është Banka e Shqipërisë. Më shumë info, ju lutem gjeni në këtë link https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Zyra_t_e_kembimit_valutor/</p>	Përfunduar	jo
10	27.07.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	02.08.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Ju lutemi gjeni me poshtë kthim përgjigjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) mbi informacionit e kërkuar, duke i kthyer përgjigje secilës pyetje si më poshtë:</p> <p>1. Në lidhje me pyetjen nr. 1 “<i>Raportimet e transfertave të dyshimta, të bëra nga institucioni juaj</i>”, DPPPP sqaron se në bazë të ligjit 9917/2008 “<i>Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</i>” (i ndryshuar) raportimet e transfertave të dyshimta dërgohen në DPPPP nga subjektet e ligjit e ligjit 9917/2008, neni 3 i tij. Konkretisht gjatë vitit 2020, në DPPPP janë dërguar 1,409 raporte të aktivitetit të dyshimtë (RAD) nga subjektet raportues (referenca faqe 7 - “Raporti vjetor 2020” të cilin e gjeni në këtë link https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti_Vjetor_2020.pdf). Gjithashtu nëse nevojitet informacion më i zgjeruar dhe krahasimor në vite, përfshirë edhe rastet që DPPPP dërgon në organet e zbatimit të ligjit, Ju lutemi konsultoni faqen zyrtare të DPPPP, online, në këtë link https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/, ku janë publikuar raportet vjetore në vite, hapësira e publikimit të “Raporteve vjetore”.</p> <p>2. Në lidhje me pyetjen nr. 2 “<i>Procesi i monitorimit të institucioneve financiare për pastrimin e parave</i>”, DPPPP sqaron se në bazë të ligjit 9917/2008 “<i>Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</i>” (i ndryshuar), përputhshmëria e subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të</p>	Përfunduar	jo

parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT) , përbën një ndër objektivat kryesorë të autoriteteve mbikëqyrëse (neni 24 i ligjit) si dhe të DPPPP. Konkretisht gjatë vitit 2020, DPPPP ka kryer në total 167 inspektime në vend dhe në distancë (përfshirë institucionet financiare). Ju lutem referojuni faqes 22-23 të “Raporti vjetor 2020” të DPPPP të cilin e gjeni në këtë link https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti_Vjetor_2020.pdf). Për më shumë informacion të të dhënave mbi mbikëqyrjen nga autoritet mbikëqyrëse duhet ti drejtoheni drejtpërdrejtë autoriteteve përkatëse. Gjithashtu nëse nevojitet informacion më i zgjeruar dhe krahasimor në vite, Ju lutemi konsultoni faqen zyrtare të DPPPP, online, në këtë link <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/> , ku janë publikuar raportet vjetore në vite, hapësira e publikimit të “Raporteve vjetore”.

3. Në lidhje me pyetjen nr. 3 “Zbatimin e legjislacionit nga ana e institucioneve”, DPPPP sqaron se në bazë të ligjit 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), përputhshmëria e subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e PP/FT, përbën një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së DPPPP. Në këtë kuadër për subjekte që nuk përmbushin nivelin e duhur të përputhshmërisë me kuadrin rregullator për PPP/FT, DPPPP vijon procesin e shqyrtimit të kundërvajtjes/ve administrative deri në dhënien e vendimit të dënimit me masë administrative (gjobë) sipas dispozitave përkatëse. DPPPP gjatë vitit 2020, nga shqyrtimi i praktikave të inspektimit dhe mbikëqyrja në distancë ka konkluduar dhe vendosur 15 masa administrative me vlerë totale 7,400,000 Lek. Ju lutemi, për më shumë referojuni faqes 24-25 të “Raporti vjetor 2020” të DPPPP të cilin e gjeni në këtë link https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti_Vjetor_2020.pdf). Gjithashtu nëse nevojitet informacion më i zgjeruar dhe krahasimor në vite, Ju lutemi konsultoni faqen zyrtare të DPPPP, online, në këtë link <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/> , ku janë publikuar raportet vjetore në vite, hapësira e publikimit të “Raporteve vjetore”.

4. Në lidhje me pyetjen e nr.4 “Rolin e Ministrisë së Financave (Sektorit të veçantë brenda ministrisë suaj), sa i takon pastrimit të parave në vendin tonë” sqarojmë se në bazë të ligjit 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës, si një institucion në varësi të Ministrit të

				<p>Financave dhe shërben si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Informacion të hollësishëm dhe krahasimor në vite për veprimtarin e DPPP në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e gjeni në këtë link https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/ , ku janë publikuar raportet vjetore në vite, hapësira e publikimit të “Raporteve vjetore”.</p> <p>Gjithashtu vlerësojmë të rëndësishme të theksojmë se bazuar në ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” adresimi i kërkesës për informimin nga çdo subjekt i interesuar duhet të respektojë kërkesat e nenit 11 “Kërkesa për informim” të këtij ligji, ku taksativisht përcaktohet se “1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij..... 4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit; b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar”</p>		
11	04.10.2021	Individ- kërkesë për informacion nga e-mail	05.10.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Ne faqen tone te web-it, ne linkun si me poshte, gjeni botimet e te gjitha raporteve vjetore dhe informacionin qe Ju kerkoni. https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/</p> <p>Ne raportimin vjetor 2013, informacioni gjendet ne faqen 12. Ne raportimin vjetor 2014, informacioni gjendet ne faqen 12. Ne raportimin vjetor 2015, informacioni gjendet ne faqen 14. Ne raportimin vjetor 2016, informacioni gjendet ne faqen 15. Ne raportimin vjetor 2017, informacioni gjendet ne faqen 17. Ne raportimin vjetor 2018, informacioni gjendet ne faqen 13-14.</p>	Përfunduar	jo
12	13.10.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	18.10.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion për të cilën ju informojmë sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në lidhje me pikat 1, 2 dhe 3 informojmë se sistemi i statistikave i mbajtur nga DPPP, nuk krijon mundësinë e filtrimit të RAD, urdhrave të bllokimit, referimeve, specifikisht me tipologji ‘transferta parash nga Shqipëria me destinacion Ekuadorin apo Kolumbinë’. Në lidhje me pikën 4 informojmë se DPPP ka përfshirë tipologji në lidhje me transferta të dyshimta me vendet e Amerikës Latine/apo vende me risk në raportet vjetore të publikuara në 	Përfunduar	jo

				faqen tonë zyrtare dhe këtu përmendim, tipologjinë nr. 2 të raportit vjetor 2017 ¹¹ faqja 22, tipologji 1 Raporti vjetor 2019 ¹² faqja 14.		
13	02.11.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	10.11.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion për të cilën ju informojmë si më poshtë vijon.</p> <p>Fillimisht vlerësojmë të bëjmë një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).</p> <p>DPPPP shërben si njësi e specializuar financiare administrative për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’ i ndryshuar. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p> <p>Pra një nga detyrat më të rëndësishme të DPPPP është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës konkretisht me Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit etj.</p> <p>Në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’ i ndryshuar, parashikon një sërë subjektesh si bankat, shoqëritë e transfertave, noterë, shoqëri ndërtimi, zyrat e këmbimeve valutore, etj. të cilët kanë detyrime për marrje masash për identifikimin, klientëve të tyre /klientëve potencialë e më tej monitorimin, sigurimin, mbajtjen e të dhënave për burimin e fondeve, të përcaktimit të risqeve brenda subjektit, të trajnimit të punonjësve të tyre, implementimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur, të raportimit pranë DPPPP të aktiviteteve të dyshimta etj.</p> <p>Pra në thelb veprimtaria e DPPPP përqendrohet në analizimin e rasteve të dyshimta të sinjalizuara nga subjekte e sipërpërmendura.</p> <p>Në rastet kur nga subjektet e ligjit sinjalizohet një rast i dyshimtë që lidhet</p>	Përfunduar	Jo

¹¹ http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2019/RaporteVjetore/Raporti_vjetor_shqip_2017.pdf

¹² http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2019/RaporteVjetore/Raporti_vjetor_shqip_2019.pdf

me transaksione apo dyshime për 'platforma on line', këto trajtohen analizohen më tej bazuar në të dhënave që disponohen apo sigurohen dhe në rast se konstatohen dyshime, dërgohen më tej për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese apo të inteligjencës.

Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar DPPP shkëmben informacion edhe me njësitë homologe të huaja (kërkesa drejt dhe nga homologët, informacione spontane).

Gjatë viteve të fundit (2017-2020) rezultojnë raportime nga subjektet e ligjit të rasteve të dyshimta të aktiviteteve (skema të dyshimta të pastrimit të parave) që lidhen me shoqëri që operojnë si 'Call Center'/'Shoqëri Tekematike'.

Nga ana DPPP janë dërguar raste në organet ligj zbatuese për subjekte juridike që operojnë si shoqëri shërbimesh telematike/on-line/'Call Center', me dyshime për aktivitet kriminal. Informojmë se DPPP ka përfshirë tipologji në lidhje me këto subjekte (shoqëri shërbimesh telematike/on-line/ 'Call Center') edhe në raportet vjetore të publikuara në faqen tonë zyrtare dhe këtu përmendim, tipologjinë nr. 5 te raporti vjetor 2018 faqja 19 , tipologji 4 Raporti vjetor 2019 faqja 18.

Gjithashtu në vitin 2018, DPPP ka kryer një analizë në lidhje me personat (fizik tregtar+juridik në një nga format e njohura) që ushtrojnë aktivitet si 'Call Center.'/Telematike dhe problematikat e evidentuara janë adresuar në organet përkatëse.

Nëse shoqëri të tilla (pra që shërbejnë si platforma online) përmbushin kushtet për të qenë subjekte të ligjit DPPP së bashku me organin mbikëqyrës përkatës (AMF) mund të marrë pjesë në inspektive të përbashkëta.

Vlen të përmendet se DPPP nuk është organ që kryen kallëzime penale por dërgon informacione me dyshime për pastrim parash apo financim terrorizmi dhe çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPP për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale (neni 22/1 ligji nr.9917/2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"(i ndryshuar).

Për sa parashtruar më sipër dhe bazuar në parashikimet ligjore përkatëse , DPPP nuk ka objekt veprimtarie evidentimin e numrit të call-center që operojnë apo janë të të regjistruara në vendin tonë, ndarjen e tyre sipas

				<p>kategorive të shërbimit që ofrojnë, platformat që përdorin etj. Duhet të evidentohet se siç dihet call-center nuk ka të njëjtin kuptim si FOREX, pasi të parat ushtrojnë një gamë të gjerë veprimtarie e cila mund të përfshijë ose jo FOREX.</p>		
14	03.11.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	12.11.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>1. Cilat janë procedurat që zbaton institucioni juaj si autoritet kontraktor për t'u siguruar që një operator ekonomik, me të cilin lidhet një kontratë prokurimi në zbatim të ligjit nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", është i besueshëm për të zbatuar kontrata të klasifikuara; struktura e pronësisë së tij është e qartë; si dhe nuk punon kundër interesave kombëtare të Shqipërisë?</p> <ul style="list-style-type: none"> Në zbatim të ligjit nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", kryesisht për prokurimet e klasifikuara procedura bazohet në VKM 542 datë 29.09.2021 "Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", zbatimi ndiqet nga struktura jone e sigurisë nga PPAK (personi përgjegjës i autoritetit kontraktor) dhe OSI (oficeri i sigurisë industrial) në bashkëpunim me DSIK, si gjatë procedurës përpara lidhjes së kontratës dhe gjatë zbatimit të kontratës. <p>2. A mund të merrni informacion lirisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë prej Regjistrimit të Pronarëve Përfitues të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit?</p> <ul style="list-style-type: none"> Të dhënat publike të regjistrimit janë mjaftueshëm të plota për nevojat e përdoruesve përfshirë DPPP. <p>Për pyetjet vijuese, Ju lutem drejtohuni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pasi janë detyra funksionale të këtij institucioni.</p>	Përfunduar	Jo
15	16.11.2021	Individ- Kerkese per informacion	24.11.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Më poshtë gjeni linqet e faqes web të DPPP, ku mund të merrni të gjithë informacionin lidhur me pyetjet Tuaja.</p> <p>https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/</p> <p>https://fiu.gov.al/sq/ligje/</p>	Përfunduar	Jo
16	26.11.2021	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	3.12.2021 Eshte percjelle pergjigja me e-mail	<p>Jemi njohur me kërkesën Tuaj, protokolluar me tonën nr.1487 datë 01.12.2021, në të cilën kërkonit në formë elektronike emrat e kompanive dhe NIPT të cilat janë verifikuar/ hetuar/ dhe referuar në Prokurori nga DPPP për pastrim parash.</p> <p>Në lidhje me sa kërkonit, na lejoni t'Ju bëjmë me dije se bazuar në Neni 22/1 "Përdorimi i të dhënave" të Ligjit nr. 9917/2008 "Për parandalimin e</p>	Përfunduar	Jo

				<p>pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), paragrafi i parë i këtij neni, citojmë “Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPP-ja për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale” kufizon kompetencat e Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si njësi e inteligjencës financiare, për të ndarë informacionet apo të dhënat e përfuara në funksion të ushtrimit të detyrave të saj, me individë apo subjekte të tjerë, përveçse me organet ligj zbatuese.</p> <p>Në vijim, Ju vëmë në dijeni se informacion në formë statistikor dhe tipologji specifike për të cilat jeni të interesuar mund ti konsultoni në faqen elektronike të DPPPP ku janë të publikuara të gjitha raportet vjetore me informacion të plotë dhe shterues për punën e DPPPP në vite.</p>		
17	06.02.2022	Qytetar- kërkesë për informacion nga e-mail	08.02.2022	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave Ju ka kthyer pergjigje edhe me pare ne lidhje me shqetesimin Tuaj, bashkelidhur ketij e-mail do te gjeni pergjigjen e derguar me pare nga DPPPP.</p> <p>I nderuar,</p> <p>DPPPP nuk ka rol në këtë proces, por sugjerojmë që të dërgoni në Itali të përkthyer dhe me vulat e duhura apostile, vendimin e apelit, si dhe të pyesni në disa banka.</p>	Përfunduar	Jo
18	07.02.2022	Gazetare- kërkesë për informacion nga e-mail	09.02.2022	<p>Jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion për të cilën ju informojmë si më poshtë vijon.</p> <p>Fillimisht vlerësojmë të bëjmë një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).</p> <p>DPPPP shërben si njësi e specializuar financiare administrative për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p> <p>Pra një nga detyrat më të rëndësishme të DPPPP është mbledhja, analizimi</p>	Përfunduar	Jo

			<p>dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit konkretisht me Prokuroritë, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, etj.</p> <p>Në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 <i>“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”</i> i ndryshuar, parashikon një sërë subjektesh si bankat, shoqëritë e transfertave, noterë, shoqëri ndërtimi, zyrat e këmbimeve valutore, etj. të cilët kanë detyrime për marrje masash për identifikimin e klientëve të tyre /klientëve potencialë e më tej monitorimin, sigurimin, mbajtjen e të dhënave për burimin e fondeve, të përcaktimit të risqeve brenda subjektit, të trajnimit të punonjësve të tyre, implementimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur, të raportimit pranë DPPPP të aktiviteteve të dyshimta etj.</p> <p>Pra në thelb veprimtaria e DPPPP përqendrohet në analizimin e rasteve të dyshimta të sinjalizuara nga subjekte e sipërpërmendura.</p> <p>Në rastet kur nga subjektet e ligjit sinjalizohet një rast i dyshimtë që lidhet me transaksione apo dyshime për ‘platforma on line’, këto trajtohen analizohen më tej bazuar në të dhënat që disponohen apo sigurohen dhe në rast se konstatohen dyshime, dërgohen më tej për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese.</p> <p>Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 <i>“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”</i> i ndryshuar DPPPP shkëmben informacion edhe me njësitë homologe të huaja (kërkesa drejt dhe nga homologët, informacione spontane).</p> <p>Gjatë viteve të fundit (2017-2021) rezultojnë raportime nga subjektet e ligjit të rasteve të dyshimta të aktiviteteve (skema të dyshimta të pastrimit të parave) që lidhen me shoqëri që operojnë si ‘Call Center’/‘Shoqëri Telematike’.</p> <p>Nga ana e DPPPP janë dërguar raste në organet ligj zbatuese për subjekte juridike që operojnë si shoqëri shërbimesh telematike/on-line/‘Call Center’, me dyshime për aktivitet kriminal. Informojmë se DPPPP ka përfshirë tipologji në lidhje me këto subjekte (shoqëri shërbimesh telematike/on-line/ ‘Call Center’) edhe në raportet vjetore të publikuara në faqen tonë zyrtare dhe këtu përmendim, tipologjinë nr. 5 te raporti vjetor</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>2018 faqja 19^[1], tipologji 4 Raporti vjetor 2019^[2] faqja 18.</p> <p>Gjithashtu në vitin 2018, DPPPP ka kryer një analizë në lidhje me personat (fizik tregtar+juridik në një nga format e njohura) që ushtrojnë aktivitet si ‘Call Center.’/Telematike dhe problematikat e evidentuara janë adresuar në organet përkatëse.</p> <p>Vlen të përmendet se DPPPP nuk është organ që kryen kallëzime penale por dërgon informacione me dyshime për pastrim parash apo financim terrorizmi dhe çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPPP për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale (neni 22/1 ligji nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”)(i ndryshuar).</p> <p>Duhet të evidentohet se siç dihet call-center nuk ka të njëjtin kuptim si FOREX, pasi të parat ushtrojnë një gamë të gjerë veprimtarie e cila mund të përfshijë ose jo FOREX.</p>		
19	09.02.2022	Noter- Kerkese per informacion	11.02.2022	<p>Ne lidhje me pyetjen Tuaj “ <i>A jane ndermjetesit subjekt i ligjit 9920, te ndryshuar</i>” sqarojmë se:</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të pastrimit të Parave (DPPPP) rregullohet nga ligji 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”(i ndryshuar) dhe referuar këtij ligji, PO ndërmjetësit janë subjekt i ligjit si edhe përcaktohet nga neni 3, pika gj. Ndërkohë ligji 9920, i ndryshuar, që referoni rezulton të jetë ligji “<i>Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë</i>” për të cilën DPPPP nuk ka kompetencë. Për më shumë duhet ti drejtoheni Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve për të marrë informacionin e kërkuar.</p>	Përfunduar	Jo
20	17.02.2022	Noter- Kerkese per informacion	18.02.2022	<p>Ju bëjmë me dije se Po ndërmjetësit dhe avokatët janë subjekt të ligjit 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar) neni 3, pika gj si dhe mospjesëmarrja Juaj me dëshirë siç citoni në email në seancat trajnuese që organizon DPPPP nuk ju përjashton nga përgjegjësia si subjekt i ligjit.</p> <p>-Në faqen zyrtare online të DPPPP-së gjendet baza ligjore mbi bazën e të</p>	Përfunduar	Jo

^[1] http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2019/RaporteVjetore/Raporti_vjetor_shqip_2018.pdf

^[2] http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2019/RaporteVjetore/Raporti_vjetor_shqip_2019.pdf

				cilit funksionon Drejtoria jonë.		
21	22.02.2022	Pune kerkimore - Kerkese per informacion Kerkese (e deleguar)	24.02.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj me anë të së cilës kërkoni informacion mbi konsultimin publik për Ligjin nr.120/2021, datë 2.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, Ju bëjmë me dije se Projektligji është hedhur ne platformën online te konsultimit publik me date 22.01.2021 dhe konsultimi publik me subjektet e ligjit eshte realizuar nëpërmjet takimit online me date 23.02.2022 ora 11:00 si dhe me grupe te tjera interesi me date 23.02.2021 ora 13:00. Gjithashtu DPPPP ka marre nëpërmjet email komente mbi projektligjin nga Eksperti Ndërkombëtar i GIZ, Delegacioni BE ne Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare E Shoqërisë se Informacionit, Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Inspektorati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.</p> <p>*Ndërkohë DPPPP i ka paraprirë konsultimit publik prej Dhjetor 2020 me grupet e interesit, kryesisht bankat dhe ka marre komente paraprake te cilat janë reflektuar dhe integruar ne versionin e projektligjit qe u publikua ne 22.01.2021.</p> <p>Bashkëngjitur këtij Email-i gjeni:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Emailet ku janë ftuar subjektet e Ligjit nr.9917/2008 per pjesëmarrje ne konsultimin publik; -Emailet me komente nga grupet e interesit Ak-Invest, Banka Credins, Banka OTP, Banka Tirana, Alpha Bank, BKT; - Dokumentacionin mbi konsultimin publik (Raporti Individual i Konsultimit Publik, Dokumenti Konsultativ, Plani i Konsultimit); - Komentet nga eksperti ndërkombëtar i GIZ; - Delegacioni i BE ne Shqiperi; - Komentet nga Ministria e Drejtesise; - Agjencia Kombëtare E Shoqërisë se Informacionit; - Komente nga Banka e Shqipërisë; -Komente nga Shoqata Shqiptare e Bankave; - Inspektorati I larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurisë; - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. 	Përfunduar	Jo
22	07.03.2022	Avokat- Kerkese per informacion	07.03.2022	<p>Në vijim të mesazhit tuaj, informojmë se subjektet e përfshira në tregtimin e mjeteve motorike janë subjekt gërmën k (viii) të nenit 3, të ligjit nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe si të tillë bazuar në nenin 12 të ligjit të sipërcituar kanë detyrimin të raportojnë në DPPPP</p>	Përfunduar	Jo

				<ul style="list-style-type: none">▪ Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë (sipas pikes 1 dhe 2 të nenit të sipërpërmëndur)për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale.▪ Transaksionet në para fizike (sipas pikes 3 të nenit të sipërpërmëndur - nëse i kryejnë), në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.		
--	--	--	--	--	--	--